



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT
REPUBLIC OF KOSOVA



REPUBLIKA KOSOVA
OPSTINA LIPJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORATI PËR PLANIFIKIM, URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Datë:	03.09.2025
Referencë:	ZR
Për:	Imri AHMETI, Kryetari Komunës
Nga:	Imri Semetishti, Drejtor i DPUMM
Kopje:	Diamant Bytyçi, Nënkyetar i Komunës Avni Jashari, Shef i Kabinetit të Kryetarit të Komunës
Lënda:	RAPORTI MUJOR I PUNËS – GUSHT 2025

Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, bazuar në detyrat e përcaktuara sipas Planit Vjetor të Punës për vitin 2025, ju dorëzon:

RAPORTIN MUJOR
TË PUNËS PËR PERIUDHËN RAPORTUESE 01.08.2025-31.08.2025

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë periudhës raportuese DPUMM- në sektorin e Urbanizmit ka zhvilluar aktivitetet themelore si vijon:

Gjatë kësaj periudhe DPUMM ka trajtuar disa prej lëndëve të pranuar dhe kërkesave të bartura. Gjatë muajit gusht 2025-janë pranuar gjithsejtë 50-kërkesa të natyrave të ndryshme, kurse të bartura kanë qenë 23 lëndë, që në total rezulton të jenë 73 lëndë për shqyrtim. Prej tyre janë trajtuar gjithsejtë 52 kërkesa, 33 të miratuara, 17 të refuzuara dhe 2 të ceduara. Për shqyrtim në muajin vijues barten 21 lëndë të natyrave të ndryshme.

Statusi i trajtimit të lëndëve të pranuar dhe atyre të bartura është prezantuar në pjesën tabelare.

Në kuadër të aktiviteteve të tjera DPUMM ka kryer edhe aktivitete të tjera.

Në fushën e shqyrtimit të kërkesave është vazhduar me intensifikimin e angazhimeve për shqyrtimin e tyre brenda afateve ligjore.

Pjesë e veçantë e shqyrtimit të kërkesave është edhe procedura e lëshimit të konkluzioneve për pagesën e taksave sipas kategorive të caktuara. Lidhur me këte janë lëshuar 16 konkluzione për pagesën e taksave.

Po, ashtu DPUMM ka përgatitur dhe adresuar te palët ftesa për plotësimin e dokumentacionit. Në kuadër të kësaj janë shqyrtuar kërkesat shtesë për plotësim dokumentacioni.

DPUMM ka trajtuar një kërkesë për qasje në dokumente. Kërkesa është proceduar me kohë.

DPUMM ka vazhduar pranimin e kërkesave për ndryshimin e Hartës Zonale të Komunës. Gjatë muajit gusht janë pranuar 5 kërkesa të tilla të cilat do të trajtohen në procesin e ndryshim plotësimit të HZK-së. Për këtë qëllim deri më tani janë pranuar 16 kërkesa.

Aktivitete të tjera janë kryer edhe si:

Pjesëmarrja në punëtorinë për Programin e Banimit Social Adekuat në Kosovë organizuar nga MMPHI dhe OSBE dt.13.08.2025

Është në zbatim e sipër programi për regjistrimin e adresave zyrtare, proces që zbatohet nga AKK. Procesi mbikëqyret dhe mbështetet nga DPUMM.

Aktivitetet themelore për muajin vijues:

Vazhdimi i angazhimeve për shqyrtimin e lëndëve.

Vazhdimi i bashkëpunimit me Drejtoratet relevante në procesin implementues të projekteve komunale.

STATISTIKAT

Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të parashtruara nga palët

Tabela 1.

<i>Nr.</i>	<i>Llojet e kërkesave</i>	<i>Të pranuar</i>	<i>Nga periudha e kaluar</i>	<i>Të miratura</i>	<i>Pushim procedure</i>	<i>Të refuzuar</i>	<i>Të bartura në sektor të tjerë</i>	<i>Në proces (pritje)</i>
1.	Kushte ndërtimore	7	5	6		1		5
2.	Leje ndërtimi	5	4	5		2		2
3.	Vazhdim i L.së ndërtim.		1	1				
4.	Leje rrënimi	2	1	2				1
5.	Certifikatë përdorimi							
6.	Tërheqje lande		1	1				
7.	Akte nga MMPHI- rish.	1						1
8.	MMPHI –pëlqim mjedisor	1		1				
9.	Informacione urbane	4	3	3		3	1	0
10.	Certifikatë legalizimi /Leje Legalizimi	4	4	4				4
11.	Legalizimi/ Në listë të pritjes							
12.	Bashkim/ndarje e parcelave	6	2	2		2		4
13.	Ndryshim i Kushteve ndërtimore	1		1				
14.	Kërkesë për LMK	5	2	3		2		2
15.	Detyra për hartim të projekteve	1		1				
16.	Qasje në dokumente	1		1				
17.	Pëlqim energjetik	1				1		
18.	Kërkesë për pezullim procedure	1				1		
19.	Kërkesë për mosnjohje të pëlqi. për ndërtim VN	1		1				
20.	Panele solare	1						1
21.	Emërtim rruge	5				4		1
22.	Kërkesë për infrastrukturë rrugore	1					1	
23.	Zhvendosje shtylle	1				1		
24.	Korrigjim i L.Ndërtim.	1		1				
	Gjithsejtë:	50	23	33		17	2	21

Sipërfaqja tokësore për ndërtim, sipërfaqja e ndërtesave dhe destinimi

Tabela 2.

<i>Nr.</i>	<i>Kategoria e ndërtimit</i>	<i>Sipërf. Tokës – m2</i>	<i>Sip.nderësës- m2</i>	<i>Destinimi</i>	<i>Vendi</i>
1.	II	5532	5164. B4 1052.7 A	NLB	Lipjan
2.	II	3436	4864.56 B 568.8 A	NLB	Lipjan
3.	II	3646	1594.66	Afarsit	Konjuh
4.	I	1249	550	Afarist	Lipjan
5.	I	500	305.60	Shtepi	Lipjan
Gjithsejtë		14363	14100.32		

Tokë e shfrytëzuar vetëm për afarizëm = 4891 m2 me gjithsejtë ndërtim për afarizëm prej 2144.66 m2.

Tokë e shfrytëzuar për banim dhe afarizëm = 9468 m2 me gjithsejtë ndërtim për banim prej 10334.16 m2 dhe 1626.5 m2 për afarizëm (NLB).

DISKUTIME PUBLIKE:

Gjatë muajit gusht 2025 nuk kemi pasur diskutimin publik.

SFIDAT:

- Mungesë e theksuar e stafit në punë për shkak të pushimeve mjekësore;
- Procesi për plotësimin e dy vendeve të lira të punës ende nuk është realizuar.

BUXHETI:

Gjatë muajit raportues kemi vazhduar me realizimin e të hyrave nga trajtimi i kërkesave për leje ndërtimore dhe kategoritë tjera. Gjatë muajit gusht 2025 janë realizuar të hyra si në vijim:

- Të hyrat për leje ndërtimore janë realizuar në shumë prej:.....63,491.54€
- Të hyrat për ndërrimin e destinimit të tokës në shumë prej:5,395.00€
- Të hyrat për leje mjedisore komunale janë realizuar në shumë prej:.....5,458.83€
- Të hyrat për legalizimin e ndërtesave pa leje janë realizuar në shumë prej:.....369.16€
- Të hyrat për Leje rrënimi janë realizuar në shumë prej715.82€

Shuma totale e të hyrave:75,430.35€

Të dhënat lidhur me të hyrat për muajin gusht 2025 janë pranuar nga sektori i financave në kuadër të Drejtoratit përkatës të Komunës së Lipjanit.